



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01- 7053/23
Kaçanik, 23.03.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **III (tretë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 23 mars 2023 (e enjte). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në zyrën e kryetarit, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri – Çaka - PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK, Arben Thaqi - OJQ. Nga Ekzekutivi i komunës në takim mori pjesë Hajrush Dullovi – zyrtar në Arsim.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Maviqe Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e III-të (tretë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2023, data 23 mars, me këtë :

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
2. Gjendja e Arsimit në komunën e Kaçanikut; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete.

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbal?

Procesverbalin e mbledhjes së II (dytë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2023, u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komiteti për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së II (dytë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2023, të datës 24.02.2023 / Lënda : 01Nr. 60/01-4504/23.

2. Gjendja e Arsimit në komunën e Kaçanikut;

z.Hajrush Dullovi: Arsimi organizohet në tre nivele: Në nivelin para fillor , niveli fillor, niveli i mesëm i ulët dhe arsimit i mesëm i lartë.

Në komunën e Kaçanikut janë gjithsej 14 shkolla amë, prej të cilave 12 shkolla janë të nivelit fillor dhe të nivelit të mesëm të ulët dhe dy shkolla të mesme, si dhe një çerdhe publike. Në përgjithësi numri i nxënësve arrijnë shifrën përafërsisht 6,000.00 (gjashtë mijë), për më saktësisht kjo tematikë është reflektuar edhe në raportin i cili është prezantuar në mbledhjen e kaluar në kuvendin komunal, i cili raport i përfshinë të gjitha detajet e sistemit arsimor në Komunën e Kaçanikut.

Në raport është prezantuar edhe numri i nxënësve për vite shkollore, ku vërehet se numri i nxënësve është në rënie të vazhdueshme dhe kjo gjë është mjaft shqetësuese. Numri i paraleleve është zvogëluar, po ashtu kemi rënie edhe tek numri i të punësuarve arsimor mirëpo kjo çështje duhet të diskutohet edhe në nivele tjera më të larta.

Sa i përket suksesit të nxënësve, mendojë që ka një ngritje të vazhdueshme të nivelit të suksesit në përgjithësi, potencoj rastin fundit ku një nxënës nga shkolla profesionale i cili ka zënë vendin e parë në lëndën e fizikës në garat e nivelit qendrorë në Kosovë.

Niveli i infrastrukturës në arsim, është i kënaqshëm duke marr parasysh që shumë prej këtyre shkollave janë me një infrastrukturë të nivelit të lartë modern dhe bashkëkohor me hapësira të mjaftueshme, përjashtua shkollën “Emin Duraku” e cila fatkeqësisht është në gjendje jo të mirë infrastrukturore.

z.Betim Shala: A ka plan për ndërtimin e një salle të edukatës fizike në fshatin Biçec ?.

z.Hajrush Dullovi : Po, një sallë e tillë është planifikuar si dhe është në procedurë, andaj brenda 2 (dy) viteve shpresojmë të përfundohet ndërtimi i saj.

z.Arben Thaqi : Duke marrë parasysh që unë jam pjesë e shkollës profesionale, dua të theksojë që sukcesi i nxënësve në këtë shkollë fillimisht mund të reflektojë me një mesatare shumë të ulët, këtë e dëshmon edhe vet emri “shkollë profesionale, që nënkupton se nuk marrin pjesë nxënësit me sukseste të shkëlqyeshëm por pjesë e kësaj shkolle bëhen nxënësit të cilët janë të interesuar për një praktikë profesionale, ku shumica prej tyre e kanë argumentuar që munden me tregu aftësi dhe shkathtësi të mira në praktiken e profesioneve të ndryshme.

Nëse e keni përcjell faqen e Qendrës së karrierës, mund të vëreni se shumica e nxënësve që kanë qenë pjesë e praktikave në shkollën profesionale tani më janë të punësuar, konkretisht në institucionin e KEK-ut.

Në këtë vit kemi një rritje të numrit të nxënësve por edhe rritje të cilësisë. Plotësisht pajtohem që të këtë një freskim të drejtimeve në shkollën profesionale, me qëllim që të rritet trendi i saj.

Një çështje e rëndësishme që luan një rol të madh në shkollë është e këshilli i prindërve në shkolla e që fatkeqësisht ky këshill nuk është funksional që d.m.th. nuk ka bashkëpunim ndërmjet shkollës dhe prindërve andaj kjo cilësohet si një e metë apo dobësi e madhe për shkollën por edhe për komunën si institucion, si rrjedhojë e kësaj vjen edhe tek mos angazhimi mësimor, përdorimi i substancave narkotike dhe zhvillimi i shumë dukurive të tjera negative nga nxënësit e këtyre shkollave, prandaj është shumë i nevojshëm ky trekëndësh i bashkëpunimit (shkolla-këshilli i prindërve, komuna) në mënyrë që ti parandalojmë dhe evitojmë dukuritë negative. Gjithashtu është shumë e

nevojshme edhe inkuadrimi i pedagogëve dhe psikologëve nëpër shkolla duke marr parasysh që janë akter të rëndësishëm në trajtimin dhe edukimin e nxënësve.

Një problem tjetër i cili është shumë shqetësues është edhe çështja e pastërtisë në shkolla, si problem shqetësues në aspektin epidemik dhe higjenik, pasi që shkollat tona nuk pastrohen mirë ndonjëherë edhe vetëm formalisht, një ashtu edhe problemi i dezinfektimit të shkollave dhe sipërfaqeve.

Rekomandoj që Komuna duhet të ndërmerr veprime apo masa urgjente lidhur higjienën në shkolla si dhe mirëmbajtjen e këtyre hapësirave apo sipërfaqeve.

z.Hajrush Dullovi : Në kuadër të komunës kemi realizuar vizita të rregullta lidhur me problematiken e ngritur nga ju për çështjen e higjienës dhe mirëmbajtjen se hapësirave në shkolla. Në përgjithësi gjendja në shkolla është relativisht e mirë përveç shkollës profesionale, ashtu që siç e dini edhe ju asnjëherë nuk ka mundur të gjendet një mirëkuptim ndërmjet drejtorit të mëparshëm të shkollës profesionale dhe pastruesve. Sa i përket inkuadrimin të pedagogëve dhe psikologëve nëpër shkolla, ju njoftoj që është duke u mbuluar kjo pjesë me sukses.

z. Ekrem Livoreka : Lidhur me sigurinë në shkolla, polica në bashkëpunim me drejtorinë e shkollave duhet të ndërmerr masa, në mënyrë që të ketë kontrolla më të shpeshta në shkolla, pasi çdo i dyti nxënës supozohet se mund të posedojë armë të ftohta dhe lëndë narkotike.

Në stacionin e autobusëve ka rrahje çdo ditë dhe këtë problematike e kam trajtuar edhe në takimin e KKS-së, me ç'rast kam bërë kërkesë tek komandanti i Policisë, që sidomos gjatë orës dy dhe shtatë të jenë prezent zyrtaret policor në stacionin e autobusëve sepse vetë prezenca e policisë e rritë sigurinë.

z.Hajrush Dullovi : Polica janë marr dhe merren vazhdimësi me trajtimin e kësaj çështje, por rasti më shqetësues ka qenë në shkollën "Emin Duraku", ku drejtoresha shumë herë ka raportuar rastet e identifikimit të armëve të ftohta tek nxënësit, d.m.th. kur i kanë kontrollua nxënësit kanë gjetë armë ftohta dhe kanë marr masa ndëshkuese.


z.Arben Thaqi : Si është orari i mësimin nëpër shkolla, a është i njëjtë apo ndryshon edhe pse janë specifike shkollat të cilat veprojnë, si dhe kohëzgjatja e mësimin për të cilën unë mendoj që nuk respektohet?

z.Hajrush Dullovi : Sipas udhëzimit administrativ të vitit 2019, kohëzgjatja e orës mësimore është 45 (katër dhjetë e pesë) minuta.

3.Të ndryshme:

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme ? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 11:50.

Procesmbajtësja
Mavije Murseli



Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka

